



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim

Uprava za Obrazovanje//Department of Education

Nr.prot:05/ 331

Datë 22.05.2026

Drejtoria për Arsim në Komunën e Shtimes, duke u bazuar në nenin 53 dhe nenin 55 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në nenin 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nxjerr këtë:

V E N D I M

I.Anulohet Konkursi për regjistrimin e fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime për vitin shkollor 2026/2027, me nr. protokoli 05/328, i datës 21.05.2026

II.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të Konkursit për regjistrimin e fëmijëve në Institucionin Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime për vitin shkollor 2026/2027, me nr. protokoli 05/328 të datës 21.05.2026, është konstatuar se propozim-konkursi i dorëzuar nga institucioni ka përmbajtur gabime të dukshme në përmbajtje dhe në aspekt procedural.

Lidhur me këtë, Institucioni Parashkollor “Albiona Asllani” në Shtime ka njoftuar Drejtorinë për Arsim për gabimet e konstatuara dhe ka dorëzuar propozim-konkurs të përmirësuar për procedim të mëtejme.

Në bazë të nenit 53 dhe nenit 55 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, organi publik ka të drejtë të anulojë aktin administrativ kur konstatohet se ai përmban mangësi ose gabime që ndikojnë në ligjshmërinë e tij, me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Një kopje i dorëzohet
IP “Albiona Asllani” në Shtime
Në arkivë të DKA-së

Udhëheqës i sektorit të arsimit

Lulzim Sahiti

